

-S.T.I.M.P
15.06.2022



BASHKIA MALIQ
Zyra e Protokollit
Nr. 3257/P
Date: 15.06.2022
krimi

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
GJYKATA E RRETHIT GJYQËSOR
KORÇË

Nr. 1379 Akti

"NJOFTIM ME SHPALLJE"

Drejtuar: Bashkise Maliq

Per te paditurin : Eduart Karamuço me adrese : Goce Bashkia Maliq

Pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Korçë u gjykua çështja civile që i'u përket palëve:

PADITËSE: Erina Karamuço

I PADITUR: Eduart Karamuço, i biri i Jorgo dhe Katerina, i dtl. 19.01.1976, lindur dhe banues ne fshatin Goce, Bashkise Maliq, Korçe, me shtetesi shqiptare, ne mungese me shpallje.

OBJEKTI: Zgjidhja e martesës ligjore etj.

Gjykata, ne seancen e dates 11.05.2022 dha vendimn nr 364 dhe Vendosi:

Zgjidhjen e martesës ligjore midis paditeses Erina Karamuco dhe te paditurit Eduart Karamuco te lidhur ne dt. 30.09.2004. Lenien e femijeve te mitur Lorenc Karamuco, i dtl. 05.01.2009 dhe loana Karamuco e dtl. 30.07.2012 per rritje dhe edukim paditeses Erina Karamuco, duke i njohur babait te tyre Eduart Karamuco te drejten per t'u takuar me femijet e tij fundjaven e pare, te dyte dhe te trete te çdo muaji nga 16⁰⁰ e dites se premte deri ne oren 12⁰⁰ te dites se diel, ndersa fundjaven e katert femijet ta kalojne me nenen.

- Takimet e babait me femijet gjate pushimeve verore nga data 1 Gusht deri ne daten 15 Gusht te cdo viti kalendarik.
- Takimet gjate pushimeve dimerores te jene nga data 1 Janar deri ne daten 5 Janar te cdo viti kalendarik.
- Takimet e babait me femijet ne ditelindje, gezime familjare, datelindjen e femijeve te dy prinderit duhet te ndajne kohen ne menyre te barabarte.

Detyrimin e te paditurit Eduart Karamuco te paguaje ne favor te femijeve te mitur Lorenc Karamuco dhe loana Karamuco si detyrim ushqimor, shumen prej 100 (njqind) euro ne muaj per secilin femije, detyrim i cili fillon nga dita e ngritjes se padise dt. 11.10.2021 bazuar ne nenin 210/1 K.Familjes.

Paditesja Erina Karamuco mer mbiemrin e saj paramartesor "Hodo".

- Shpenzimet gjyqesore ne shumen 23 260 (njezet e tremije e dyqind e gjashtedhete) leke ju ngarkohen paleve ne menyre te barabarte.

Ky vendim perben titull ekzekutiv ne lidhje me detyrimin per kontribut ushqimor dhe te drejten e takimit te femijeve dhe me ekzekutimin e tij ngarkohet sherbimi permbarimor gjyqesor, shteteror ose privat, sipas kerkeses se kreditorit. Urdherohet sekretaria e gjykates, qe pasi vendimi te marre forme te prere, t'i dergoje nje kopje te tij Zyres te Gjendjes Civile Bashkia Maliq per te bere ndryshimet perkatese ne rregjister. Kunder ketij vendimi lejohet te behet ankim ne Gjykatën e Apelit Korçe, brenda 15 diteve, duke filluar nga dita e neserme e njoftimit te vendimit te arsyetuar. U shpall ne Korçe, sot me date 11.05.2022.

Nje kopje e shpalljes do te afishohet pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Korçë, si gjykata ku gjykohet mosmarrëveshja, një kopje pranë vendbanimit Tuaj zyrtar, një kopje prane Bashkise Maliq, si dhe në faqen zyrtare të gjykatës.

Kjo shpallje do të qëndroje e afishuar në vendet e mësipërme minimalisht 20 (njëzet ditë) nga data e afishimit. Shpallja do t'iu dërgohet në dy kopje, njëra prej të cilave duhet të përcillet në gjykatë, menjëherë pas afishimit.

Shpallja u afishua sot në datë _____.

Per Bashkine Maliq
(emër, mbiemër, firmë)



nr. 74 Prot